

# REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

Paraburgimi si normë: Ndikimi i kulturës  
gjyqësore në caktimin e masave të  
sigurimit

Prof. Asoc. Adrian LEKA, PhD

Brunilda HAXHIU



Financuar nga  
Bashkimi Evropian





---

**PUBLIKUES**

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)  
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)  
Tel: +355 44 104 247  
E-mail: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)  
Web: [www.em-al.org](http://www.em-al.org)

**AUTORË**

Prof. Asoc. Adrian LEKA, PhD  
Brunilda HAXHIU  
shtator 2025

**VITI I PUBLIKIMIT**

---

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
KORNIZA TEORIKE: KULTURA E RREZIKUT NË VENDIMMARRJEN GJYQËSORE	04
• Rishikimi i literaturës mbi vendimmarrjen gjyqësore	04
• Paragjykimet konjitive dhe heuristikat	04
• Qëndrimet personale	04
• Faktorët institucionalë dhe presioni profesional	05
• Vendimmarrja për paraburgimin në literaturën globale	05
KONTRIBUTI DHE ARGUMENTI TEORIK	05
• Konceptualizimi i teorisë së 'kulturës së rrezikut'	05
SITUATA NË SHQIPËRI: ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE DHE ZBATIMIT TË SAJ	07
• Korniza ligjore	07
• Zbatimi në praktikën gjyqësore	09
ANALIZA EMPIRIKE	12
Përfundime	14
REFERENCA	15
BIBLIOGRAFIA	18

Gjatë muajve të fundit, disa hetime penale me profil të lartë e kanë zhvendosur pjesërisht fokusin e debatit publik mbi reformën në drejtësi nga legjitimiteti i saj politik tek prirja e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mbajtur në paraburgim personat nën hetim. Në të vërtetë, një numër studimesh, raportesh dhe artikujsh kanë theksuar se, edhe pse Kodi i Procedurës Penale parashikon se paraburgimi caktohet si masë e fundit, gjyqtarët e caktojnë atë në mënyrë rutinore, madje edhe në raste kur ekzistojnë kushte të përshtatshme për masa të tjera më pak kufizuese.

Ky fenomen ngre pyetjen: përse gjyqtarët zgjedhin kaq shpesh masën më të rëndë, edhe kur ligji dhe standardet europiane kërkojnë alternativa më të buta? Për ta kuptuar këtë, duhen parë jo vetëm dispozitat ligjore, por edhe mënyra se si gjyqtarët e konceptojnë rolin e tyre dhe dilemat që shoqërojnë vendimmarrjen gjyqësore.

Në këtë artikull, ne mbështetemi mbi kornizën teorike të kulturës së rrezikut për të shpjeguar mbipërdorimin e paraburgimit në Shqipëri. Ideja themelore e artikullit është se gjyqtarët, të ekspozuar ndaj presioneve publike, politike dhe institucionale, shpesh vendosin masa shtrënguese jo vetëm mbi bazën e provave, por edhe si strategji mbrojtëse ndaj rrezikut të kritikave ose ndëshkimeve. Kjo qasje na lejon të kuptojmë pse, pavarësisht reformave ligjore dhe monitorimit ndërkombëtar, praktika e paraburgimit në Shqipëri mbetet rezistente ndaj ndryshimit.

Rëndësia e këtij studimi është e dyanshme, si në planin akademik, ashtu edhe në atë praktik.

Akademikisht, ai kontribuon në literaturën mbi ndërveprimin mes kulturës juridike dhe praktikave të vendimmarrjes gjyqësore, duke e pasuruar teorinë e kulturës së rrezikut me një rast nga një sistem në tranzicion. Praktikisht, analizat dhe gjetjet e tij mund të ndihmojnë politikëbërësit dhe aktorët e sistemit të drejtësisë të kuptojnë mekanizmat e brendshëm që çojnë në mbipërdorimin e paraburgimit dhe të ndërtojnë strategji më efektive për ta kufizuar atë në përputhje me standardet europiane të të drejtave të njeriut.

## KORNIZA TEORIKE: KULTURA E RREZIKUT NË VENDIMMARRJEN GJYQËSORE

### Rishikimi i literaturës mbi vendimmarrjen gjyqësore

Studimi i vendimmarrjes gjyqësore ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë dekadave të fundit, duke kaluar nga një qasje formale-normative në një qasje më empirike dhe ndërdisiplinore. Që nga koha e shprehjes së famshme: 'drejtësia është çka ka ngrënë për mëngjes gjyqtari', që i atribuohet pionierit të studimeve mbi personalitetin e gjyqtarit, Xherom Frenk (Priel, 2017),[1] pothuajse çdo faktor ekstragjyqësor që mund të ndikojë në vendimmarrjen e gjyqtarit është studiuar nga një shumëllojshmëri disiplinash.[2]

### Paragjykimet konjitive dhe heuristikat

Shkenca konjitive ka treguar se proceset vendimmarrëse nuk janë gjithmonë produkt i arsytimit racional, por shpesh i mekanizmave intuitivë e të pavetëdijshëm (Tversky dhe Kahneman, 1974; Kahneman, 2011; Jolls dhe Sunstein, 2004).[3] Literatura ka dokumentuar një sërë paragjykimesh të nënkuptuara dhe heuristikash[4] tek gjyqtarët, si: ankorimi (Bystranowski et al., 2021),[5] inkuadrimi (Guthrie, Rachlinski & Wistrich, 2001),[6] gabimi i kumarxhiut (Chen & Moskowitz, 2016),[7] retrospektiva (Oeberst & Goeckenjan, 2016),[8] si dhe kufizimet në të kuptuarit e probabiliteteve (Sonnemans & Van Dijk, 2012).[9]

Vendimmarrja gjyqësore është veçanërisht e

prekshme nga paragjykimet për shkak të kompleksitetit të çështjeve (Simon, 2004). Gjyqtarët shpesh krijojnë narrativa koherente bazuar në prova të pjesshme,[10] por kjo sjell rrezikun e shtrembërimit të fakteve. Studime të shumta kanë evidentuar rrezikun e besimit të tepërt tek dëshmitarët okularë,[11] pohimet nën presion[12] apo aktet e ekspertimit.[13] Këto gjetje lidhen drejtpërdrejt me vendimmarrjen për masat e sigurimit, pasi prova e dobët ose e paragjykuar mund të çojë drejt paraburgimit të padrejtë.

Debatet më të fundit përfshijnë përdorimin e mjeteve të vlerësimit të riskut, të cilat, megjithëse mund të ndihmojnë në standardizimin e vendimmarrjes, rrezikojnë të përforcojnë paragjykimet racore ose strukturore (Viljoen et al., 2019; Skeem et al., 2020). Po ashtu, literatura mbi përdorimin e algoritmeve parashikuese e shton dimensionin e diskutimit mbi drejtësinë procedurale dhe barazinë para ligjit.

### Qëndrimet personale

Modeli i qëndrimeve sugjeron se gjyqtarët ndikohen nga ideologjia dhe pikëpamjet e tyre (Segal & Spaeth, 1993). Megjithatë, kërkimet eksperimentale tregojnë se ata shpesh përpiqen të vendosin drejt, edhe pa interes personal (Engel & Zhurakhovska, 2017). Ndikimi i paragjykimeve të pavetëdijshme mbetet i pranishëm, sidomos mbi racën (Rachlinski et al., 2008), gjininë (Miller, 2019), etninë (Choi, Harris & Waisanen, 2022) dhe stereotipet (Funk & Todorov, 2013). Edukimi ligjor mund t'i zbusë disa efekte të këtyre paragjykimeve, por nuk mund t'i largojë ato plotësisht (Girvan, 2016).

---

## Faktorët institucionalë dhe presioni profesional

Vendimmarrja gjyqësore ndikohet nga elementë proceduralë dhe institucionalë: radhitja e argumenteve (Englich, Mussweiler & Strack, 2005),[14] diskrecioni në caktimin e dënimit (Hofer, 2007),[15] përdorimi i teknologjisë në sallën e gjyqit (Bild, Redman et al., 2021),[16] ngarkesa e madhe e punës (Engel & Weinshall-Margel, 2020)[17] dhe frika nga apelimi (Feess & Sarel, 2018).[18]

Kërkime të tjera tregojnë se respektimi i gjyqtarëve nga publiku varet jo vetëm nga rezultati, por edhe nga perceptimi i drejtësisë procedurale (Woodson, 2015; Bentsen, 2019). [19] Kjo është e rëndësishme për rastet e paraburgimit, ku transparenca dhe proporcionaliteti janë elemente kyçe për të shmangur perceptimin e vendimeve të padrejta.

---

## Vendimmarrja për paraburgimin në literaturën globale

Kërkimet empirike në shkallë globale kanë treguar se paraburgimi shpesh përdoret më gjerësisht sesa synohet nga vetë ligji, duke u bërë një masë rutinore, në vend që të ngelet një masë e fundit dhe e jashtëzakonshme. Në kontekstin europian, studimet krahasuese kanë vënë në dukje dallime të mëdha midis shteteve në zbatimin e kritereve të proporcionalitetit dhe nevojës (Cape & Namoradze, 2012; Morgernstern, 2023). Raporte të ndryshme (Fair Trials, 2014; EC, 2022) evidentojnë tendencën e mbipërdorimit të paraburgimit, e cila është shpesh e lidhur me perceptimet e gjyqtarëve mbi rrezikun e arratisjes apo përsëritjes së krimit.

Në Amerikën Latine dhe SHBA, studimet kanë treguar ndikimin e faktorëve si presioni publik, politika penale dhe praktikat e prokurorisë në përdorimin e paraburgimit (Feeley & Simon, 1992). Shumë studime kanë theksuar peshën e pabarazive racore dhe socio-ekonomike në vendimmarrjen gjyqësore mbi masat e sigurimit.

---

## KONTRIBUTI DHE ARGUMENTI TEORIK

Rishikimi i literaturës tregon se vendimmarrja gjyqësore ndikohet nga një shumëllojshmëri faktorësh konjitivë, personalë dhe institucionalë. Megjithatë, mungon ende një analizë e integruar që lidh këto gjetje me kontekstin specifik të paraburgimit në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit. Integrimi i literaturës mbi kulturën e rrezikut, raportet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së është thelbësor për të ndërtuar një kornizë analitike që shpjegon jo vetëm se pse gjyqtarët bien nën ndikime ekstrajgyqësore, por edhe si këto ndikime materializohen në vendime mbi lirinë personale.

---

## Konceptualizimi i teorisë së 'kulturës së rrezikut'

Një dimension i rëndësishëm teorik që mund të integrohet në analizimin e shkallës së përdorimit të paraburgimit në Shqipëri është koncepti i 'kulturës së rrezikut'. Ky koncept, i zhvilluar fillimisht nga Meri Dagllas (Douglas, 1992) dhe, më pas, i aplikuar në kontekstin e drejtësisë penale nga Fili dhe Sajmon (Feeley & Simon, 1992), mund të na ndihmojë të kuptojmë se pse gjyqtarët preferojnë

paraburgimin, duke e konceptuar atë si një masë mbrojtëse ndaj kritikave institucionale dhe publike. Ky koncept integrohet mirë edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi nenin 5 të KEDNJ-së (p.sh.: Letellier kundër Francës, 1991; Buzadji kundër Moldavisë, 2016) dhe bëhet i domosdoshëm për të kuptuar implikimet normative të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me paraburgimin.

Dagllas (1992) argumentoi se rreziku nuk është një realitet thjesht objektiv, por një konstrukt kulturor që përdoret nga institucionet për të shpërndarë përgjegjësinë dhe për të justifikuar veprimet e tyre. Ajo e përshkruan perceptimin e rrezikut si të rrënjësor në vlerat dhe strukturat shoqërore: 'nuk ka rrezik të pastër, vetëm kuptime kulturore të rrezikut' (Douglas, 1992). Sipas saj, shoqëritë nuk i identifikojnë apo i rendisin rreziqet në bazë të një analize shkencore neutrale. Përkundrazi, zgjedhja e rreziqeve që theksohen dhe mënyra se si menaxhohen ato reflekton vlerat, hierarkitë dhe konfliktet kulturore të një shoqërie. Ky model teorik është i rëndësishëm për të kuptuar se si gjyqtarët në sisteme të caktuara mund ta shohin paraburgimin si mënyrën më të arsyeshme për të shmangur pasigurinë.

Në praktikë, kjo nënkupton se vendimi për të mbajtur të dyshuarit në paraburgim nuk është thjesht produkt i analizës juridike mbi nevojën dhe proporcionalitetin, por edhe një reflektim i kornizës kulturore që preferon shmangien e rrezikut ndaj mbrojtjes së të drejtave individuale. Fili dhe Simon ndërtojnë mbi këtë logjikë teorinë e 'new penology – penologjisë së re', duke treguar se sistemi modern i drejtësisë synon menaxhimin e popullatave të rrezikshme, jo ndëshkimin apo rehabilitimin e individëve

fajtorë (Feeley & Simon, 1992). Ky është një zhvillim që përshtatet me kulturën e rrezikut, në të cilën paraburgimi nuk shihet vetëm si mjet ndëshkues, por edhe si instrument për të menaxhuar pasigurinë.

Në vijim, Hana-Mofat e ka interpretuar këtë zhvillim si pjesë e logjikës së menaxhimit të rrezikut, sipas së cilës masat e sigurimit përdoren për të demonstruar kontroll dhe për të transferuar përgjegjësinë nga individit tek sistemi (Hannah-Moffat, 2005). Më tej, Sajmon po ashtu e ka përshkruar këtë dukuri si një strategji që e paraqet paraburgimin si zgjedhje të vetëkuptueshme, duke i hequr gjyqtarit barrën e individualizimit të vendimit (Simon, 2007).

Kjo kornizë teorike mund të përdoret për të analizuar disa dimensione të kulturës së rrezikut në gjyqësor në Shqipëri. Së pari, dimensionin individual i saj nënkupton që gjyqtari përpiqet të shmangë rrezikun personal (p.sh.: dëmtimin e reputacionit, ndëshkimin disiplinor, etj). Së dyti, dimensionin institucional ka të bëjë me tendencën e sistemit gjyqësor në tërësi për të treguar se po 'asgjëson rrezikun', nëpërmjet përdorimit të paraburgimit si normë. Së treti, dimensionin simbolik e sheh paraburgimin si një instrument për të treguar vendosmëri ndaj krimit dhe për të forcuar besimin e publikut, edhe nëse kjo bie ndesh me standardet e të drejtave të njeriut.

## SITUATA NË SHQIPËRI: ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE DHE ZBATIMIT TË SAJ

Analiza e situatës në Shqipëri kërkon ndërthurjen e dy aspekteve: kornizës ligjore që rregullon masat e sigurimit personal dhe praktikës gjyqësore që e zbaton atë. Ndërsa ligji parashikon standarde të qarta mbi proporcionalitetin dhe subsidiaritetin, duke e përcaktuar arrestin në burg si masë të jashtëzakonshme, të dhënat nga praktika gjyqësore tregojnë një prirje drejt përdorimit të shpeshtë dhe rutinor të tij. Kjo pjesë e studimit shqyrton fillimisht bazën ligjore, më pas mënyrën e arsyetimit gjyqësor dhe, më në fund, faktorët strukturorë dhe institucionalë që ndikojnë në këtë prirje.

### Korniza ligjore

Analiza e praktikës gjyqësore në Shqipëri fiton kuptim më të plotë kur vendoset në raport me standardet ndërkombëtare dhe sidomos me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ) përbën bazën kryesore normative. Ky nen garanton të drejtën themelore për liri dhe siguri dhe përcakton rastet e kufizuara kur një person mund të privohet ligjërisht nga liria. Ndër këto raste përfshihet edhe paraburgimi, por vetëm nëse ai është i parashikuar me ligj, i bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen e një veprë penale dhe i urdhëruar nga një autoritet gjyqësor i pavarur. Jurisprudenca e GJEDNJ-së e ka përcaktuar qartë se paraburgimi duhet të jetë

masë e jashtëzakonshme, e justifikuar vetëm në rrethana të caktuara dhe të arsyetuara.

GJEDNJ-ja ka theksuar vazhdimisht se neni 5 duhet të interpretohet ngushtë, duke pasur parasysh rëndësinë themelore të lirisë personale në një shoqëri demokratike. Kufizimet e lirisë lejohen vetëm kur janë absolutisht të domosdoshme dhe të justifikuara me arsye konkrete.

Disa nga interpretimet e qendrueshme që GJEDNJ-ja ka bërë për zbatimin e nenit 5 janë veçanërisht relevante për këtë analizë:

- Çdo kufizim i lirisë duhet të jetë i parashikuar me ligj dhe në përputhje me parimet e sigurisë juridike. Në çështjen Winterwerp kundër Holandës (1979), GJEDNJ-ja saktësoi se ligjshmëria nënkupton jo vetëm përputhje me normën e brendshme, por edhe me vetë thelbin e Konventës. Në rastin e paraburgimit, kjo do të thotë se një individ nuk mund të mbahet thjesht mbi bazën e dyshimit të përgjithshëm, por vetëm nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të mbështetura nga prova dhe nëse paraburgimi është masa e fundit për arritjen e një qëllimi legjitim, si shmangia e ikjes ose parandalimi i pengimit të drejtësisë.
- Çështja Buzadji kundër Moldavisë (2016) përbën një pikë referimi për të gjitha shtetet anëtare. Gjykata vendosi se, pas fazës fillestare të procedimit, vetëm ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm nuk mjafton për të justifikuar vazhdimin e paraburgimit. Gjyqtarët duhet të japin arsyetim konkret dhe të individualizuar,

duke treguar se ekzistojnë rreziqe reale (p.sh: ikja, prishja e provave, rreziku i kryerjes së veprave të tjera). Nëse nuk jepet një arsyetim i tillë, paraburgimi konsiderohet në shkelje të nenit 5.

- GJEDNJ-ja ka sanksionuar se autoritetet duhet të tregojnë se asnjë masë tjetër më pak kufizuese nuk është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e procesit penal. Rastet Letellier kundër Francës (1991) dhe Ilijkov kundër Bullgarisë (2001) kanë treguar se përdorimi mekanik i paraburgimit, vetëm mbi bazën e rëndësisë së veprës penale ose perceptimit të rrezikshmërisë së saj, është në kundërshtim me Konventën.
- Neni 5/3 kërkon që paraburgimi të mos zgjasë më shumë se sa është rreptësisht e nevojshme. GJEDNJ-ja ka kritikuar shpesh shtetet për vonesa të pajustificuara, duke kërkuar që, gjatë gjithë periudhës së paraburgimit, gjykatat të rishikojnë në mënyrë aktive dhe periodike ekzistencën e kushteve për vazhdimin e masës.
- Një tjetër kërkesë thelbësore e GJEDNJ-së është që vendimet gjyqësore që disponojnë në lidhje me paraburgimin duhet të përbajnë arsyetim të plotë, të personalizuar, të lidhur me faktet konkrete dhe jo të kufizuar në fraza standarde (Ilijkov kundër Bullgarisë, 2001).

Në këtë kuptim, neni 5 i KEDNJ-së, ashtu siç është interpretuar nga GJEDNJ-ja, vendos kufij të fortë për caktimin e paraburgimit, duke e konsideruar atë si masë të jashtëzakonshme. Për më tepër, GJEDNJ-ja ka theksuar se çdo tejkallim i standardeve të mësipërme rrezikon të

shndërrojë paraburgimin në një dënim të fshehur para gjykimit, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë (Ilijkov kundër Bullgarisë, 2001).

Korniza ligjore shqiptare për masat e sigurimit personal është, gjithashtu, e ndërtuar mbi parimet e proporcionalitetit dhe subsidiaritetit dhe përcakton qartë se paraburgimi duhet të përdoret vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Ky standard buron nga Kushtetuta, e cila parashikon se askush nuk mund të privohet nga liria përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe vetëm nëpërmjet vendimit të gjykatës.[20] Ky parashikim konkretizohet në Kodin e Procedurës Penale.

Nenet 228 dhe 229 theksojnë se masa e sigurimit duhet të jetë gjithmonë proporcionale dhe e domosdoshme për qëllimet e procesit penal, ndërsa kriteret e përgjithshme për caktimin e masave përfshijnë rreziqet e arratisjes, dëmtimit të provave dhe përsëritjes së veprës penale. Neni 230 thekson se masa e arrestit në burg mund të caktohet vetëm kur çdo masë tjetër më pak kufizuese është e pamjaftueshme për të garantuar zhvillimin e procesit penal, ndërsa neni 232 rendit masa alternative ndaj paraburgimit, si ndalimi i daljes jashtë shtetit, detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar, garancia pasurore, arresti në shtëpi dhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik. Këto dispozita, të para në harmoni me të gjitha kapitullin e KPP-së për masat e sigurimit, janë në përputhje, me standardet ndërkombëtare, përfshirë nenin 5 të KEDNJ-së dhe Rekomandimin Rec(2006)13 të Këshillit të Europës mbi caktimin e paraburgimit dhe masave alternative.

---

## Zbatimi në praktikën gjyqësore

Të dhënat empirike tregojnë se niveli i përdorimit të paraburgimit në Shqipëri është shumë më i lartë nga sa parashikohet nga korniza ligjore. Një studim tregoi në, në vitin 2004, shkalla e miratimit të kërkesave për caktimin e arrestit në burg në Gjykatën e Tiranë ishte 98%, kurse në vitin 2008 kjo shifër ishte mbi 96% (Sufaj, 2009). Një raport i OSBE-së ka vënë në dukje që shpesh tejkalohe afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, duke treguar një tendencë për të vepruar në kundërshtim me frymën e ligjit (OSBE, 2003).

Në nivel kombëtar, statistikat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2024 tregojnë një prirje të qartë drejt përdorimit të masës së arrestit me burg. Kjo masë caktohet 1,7 herë më shumë se detyrimi i paraqitjes dhe 4,5 herë më shumë se arresti në shtëpi. Garancia pasurore, nga ana tjetër, është shumë e rrallë: në vitin 2024, kjo masë u caktua vetëm për 15 persona, përkundërt 3 866 personave të arrestuar (MD, 2025). Preferenca për caktimin e një mase sigurimi, veçanërisht për arrestin në burg konfirmohet edhe nga të dhënat e Prokurorisë së Përgjithshme.[21] Këto shifra tregojnë qartë se paraburgimi vijon të dominojë në praktikën gjyqësore shqiptare, ndërsa masat më pak kufizuese përdoren në mënyrë shumë më të kufizuar. Ky disproporcion konfirmon se, pavarësisht kornizës ligjore që favorizon proporcionalitetin dhe subsidiaritetin, paraburgimi vazhdon të jetë masa standarde në vendimmarrjen gjyqësore.

Për periudhën janar–dhjetor 2024, sipas të dhënave të sistemit të burgjeve, të paraburgosurit kanë përbërë rreth 62% të popullsisë së burgjeve (MD, 2025), një raport që tejkalon dukshëm mesataren europiane[22] dhe që dëshmon për përdorimin e gjerë të arrestit në burg.[23] Ky disproporcion, i cili ka vite që vazhdon (CPT, 2023), e forcon argumentin se paraburgimi, në vend që të funksionojë si masë e jashtëzakonshme, vazhdon të përdoret si praktikë standarde.

Kjo çështje është evidentuar edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili, në Rezolutën ‘Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023’, i ka rekomanduar Prokurorisë së Përgjithshme të nxisë aplikimin e masave alternative të sigurimit, duke përfshirë masat shtrënguese me karakter pasuror për veprat penale dhe/ose autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, një zhvillim i rëndësishëm në vitin 2024 ishte miratimi i Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 57, datë 25.07.2024 të Prokurorit të Përgjithshëm, ‘Për masat e sigurimit’, i cili i orienton prokurorët për mënyrën e kërkimit dhe mbikëqyrjes së masave të sigurimit. Udhëzimi nënvizon se paraburgimi është masë e jashtëzakonshme dhe duhet të aplikohet vetëm pasi të jenë vlerësuar të gjitha masat alternative. Ai kërkon arsyetim të individualizuar, respektim të parimit të mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, si dhe mbrojtje të veçantë për të miturit dhe grupet vulnerabël. Ai vendos, gjithashtu, detyrimin për kontroll periodik të domosdoshmërisë së paraburgimit dhe për mbikëqyrje të rreptë të ekzekutimit të masave.

Megjithatë, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 231, datë 17.4.2025, 'Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2025', trajtohet sërish çështja e caktimit të arrestit në burg më shumë se masat e tjera shtrënguese, si për prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm, ashtu edhe për Prokurorinë e Posaçme, dhe bëhen rekomandime që të rritet përdorimi i masave alternative.[24] Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se kërkesat e palëve për masa alternative nuk merren parasysh nga gjykata (Gëllçi kundër Shqipërisë, 2025) apo se paraburgimi vendoset edhe kur të pandehurit dorëzohen vullnetarisht (Hysa kundër Shqipërisë, 2023).

Përveç caktimit të tepruar të arrestit në burg, mjaft raporte kanë vërejtur se vendimet për caktimin e masave të sigurimit shpesh janë të mangëta në arsyetim dhe japin përshtypjen se paraburgimi caktohet në mungesë të kriterëve ligjore, ndërsa afatet kohore të paraburgimit tejkalohen rregullisht (OSBE, 2003, 2006; KSHH, 2020). Një pjesë e mirë e vendimeve nuk shpjegojnë pse masat më pak kufizuese nuk do të ishin të përshtatshme, duke krijuar një kulturë gjyqësore të mbizotëruar nga paraburgimi. Mangësitë në arsyetimin e vendimeve janë vënë në dukje vazhdimisht edhe nga GJEDNJ-ja. Në çështjen Hysa kundër Shqipërisë (2023), gjykata gjeti shkelje të nenit 5, pasi gjykatat e vendit ishin bazuar në arsyetime formale dhe nuk kishin marrë në konsideratë rrethanat personale. Në çështjen Gëllçi kundër Shqipërisë (2025), gjykata gjeti se kishte patur vetëm referenca të përgjithshme ndaj rrezikut të ikjes dhe prishjes së provave, pa u bazuar në prova.

Dimensioni procedural i së drejtës për t'u mbrojtur ka një ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen mbi masat e sigurimit. Në vendin tonë ka pengesa serioze për ushtrimin e hershëm dhe efektiv të kësaj të drejtë, si dhe për marrjen e akteve, me qëllim kundërshtimin e masës së sigurimit (Fair Trials, 2020). Këto pengesa dobësojnë kontrollin gjyqësor substancial dhe favorizojnë automatizmin në caktimin e masës. Veçanërisht problematike rezultojnë mbrojtja kryesisht, pasi shpesh avokatët e caktuar nuk studiojnë dosjen, nuk zhvillojnë takime me personin nën hetim dhe nuk hartojnë një strategji të mirëfilltë mbrojtjeje (KSHH, 2020). Për më tepër, rezultojnë shpesh avokatët kryesisht nuk e kanë fare mundësinë për të folur me klientin e tyre para se të zhvillohet seanca e caktimit të masës (KSHH, 2020), si dhe është konstatuar monopolizimi i skemës së mbrojtjes kryesisht, me një numër të kufizuar avokatësh që marrin pjesë në mënyrë të përsëritur në seancat gjyqësore me të njëjtët prokurorë dhe gjyqtarë, duke i dhënë procesit karakter mekanik dhe duke cenuar parimin e barazisë (KSHH, 2020).

Një tjetër problem strukturor lidhet me mekanizmat e rishikimit periodik të paraburgimit. Sipas Kodit të Procedurës Penale, çdo dy muaj prokurori duhet të informojë gjykatën mbi hetimet e kryera dhe nevojën e vazhdimin të masës. Në praktikë, ky detyrim shpesh neglizhohet (KSHH, 2020), duke penguar krijimin e kushteve reale për rivlerësimin e domosdoshmërisë së paraburgimit. Në çështjen Muçaj kundër Shqipërisë (2023), GJEDNJ-ja ka gjetur se mosfunksionimi i mekanizmave të rishikimit ka sjellë zgjatjen e paraburgimit për më shumë se tre vjet duke u bazuar vetëm në rëndësinë e akuzës.

Në raportin periodik pas vizitës së vitit 2023, CPT (Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës) vëren se zvarritjet dhe ngarkesa kanë ndikuar në rritjen shqetësuese të normës së të paraburgosurve në popullsinë e burgjeve, duke qenë një nga faktorët kryesorë të mbipopullimit të tyre. CPT rekomandon shprehimisht 'kufizimin e përdorimit të paraburgimit' dhe zgjerimin e masave të tjera, duke theksuar nevojën e trajnimit të autoriteteve hetimore e gjyqësore për ta braktisur praktikën e paraburgimit 'të panevojshëm' (CPT, 2023).

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e masave alternative është një nga shkaqet e tjera strukturore që sjell zbatimin e pakët të tyre dhe, për rrjedhojë, caktimin e shpeshtë të arrestit në burg. Arresti në shtëpi paraqitet problematik, për shkak të burimeve njerëzore që kërkon për ruajtjen e personave (Ora News, 2025). Mbikëqyrja elektronike, e cila u vu në zbatim për të bërë të mundur këtë gjë, nuk është në funksion që prej vitit 2018 (Shërbimi i Provës, 2024). Nga masat e tjera shtrënguese, vetëm detyrimi i paraqitjes zbatohet në mënyrë të rregullt për personat me rrezikshmëri të ulët, kurse garancia pasurore mbetet pothuajse e pazbatueshme (MD, 2025).

Në planin politik, për vite me radhë rekomandimet e Kuvendit drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme kanë shkuar drejt ashpërsimit të politikës penale për masat e sigurimit. Vetëm së fundmi, rekomandimet e Këshillit të Ministrave kanë filluar të orientohen drejt stimulimit të masave alternative, duke reflektuar presionin e aktorëve ndërkombëtarë dhe raportet kritike mbi mbipërdorimin e paraburgimit.

shndërrojë paraburgimin në një dënim të fshehur para gjykimit, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë (Ilijkov kundër Bullgarisë, 2001).

Korniza ligjore shqiptare për masat e sigurimit personal është, gjithashtu, e ndërtuar mbi parimet e proporcionalitetit dhe subsidiaritetit dhe përcakton qartë se paraburgimi duhet të përdoret vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Ky standard buron nga Kushtetuta, e cila parashikon se askush nuk mund të privohet nga liria përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe vetëm nëpërmjet vendimit të gjykatës.[20] Ky parashikim konkretizohet në Kodin e Procedurës Penale.

Nenet 228 dhe 229 theksojnë se masa e sigurimit duhet të jetë gjithmonë proporcionale dhe e domosdoshme për qëllimet e procesit penal, ndërsa kriteret e përgjithshme për caktimin e masave përfshijnë rreziqet e arratisjes, dëmtimit të provave dhe përsëritjes së veprës penale. Neni 230 thekson se masa e arrestit në burg mund të caktohet vetëm kur çdo masë tjetër më pak kufizuese është e pamjaftueshme për të garantuar zhvillimin e procesit penal, ndërsa neni 232 rendit masa alternative ndaj paraburgimit, si ndalimi i daljes jashtë shtetit, detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar, garancia pasurore, arresti në shtëpi dhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik. Këto dispozita, të para në harmoni me të gjitha kapitullin e KPP-së për masat e sigurimit, janë në përputhje, me standardet ndërkombëtare, përfshirë nenin 5 të KEDNJ-së dhe Rekomandimin Rec(2006)13 të Këshillit të Europës mbi caktimin e paraburgimit dhe masave alternative.

## ANALIZA EMPIRIKE

---

Një pikënisje thelbësore e kësaj analize është fakti se mbipërdorimi i paraburgimit në Shqipëri nuk mund të shpjegohet vetëm nga faktorët teknikë të renditur më lart, siç janë boshllëqet e ligjit, paqartësitë procedurale apo mungesa e burimeve njerëzore e financiare. Korniza ligjore, siç u theksua, është në përputhje me standardet europiane, pasi parashikon proporcionalitetin, subsidiaritetin dhe liston një gamë të gjerë masash alternative. Megjithatë, statistikat dhe raportet empirike tregojnë se gjykatat shqiptare vazhdojnë të zgjedhin në mënyrë rutinore masën më kufizuese edhe kur ekzistojnë kushte ligjore për masa më të buta.

Ky hendek mes normës dhe praktikës nuk shpjegohet mjaftueshëm as nga mungesa e infrastrukturës për mbikqyrjen e masave alternative. Ky faktor mund të shpjegojë pse disa nga alternativat janë më pak të përdorura, por ai nuk shpjegon se pse nuk përdoren masa të tjera alternative, për të cilat ekzistojnë mekanizmat e mbikqyrjes, dhe as pse paraburgimi është kthyer në normë, pavarësisht se ligji e koncepton si masë të jashtëzakonshme.

Në vijim, as ngarkesa e lartë dhe stoku i çështjeve në gjykata nuk e shpjegojnë bindshëm caktimin e paraburgimit si normë. Paraburgimi është evidentuar si praktikë dominuese prej shumë vitesh, përpara se ngarkesa gjyqësore të arrinte nivelet kritike të sotme, çka tregon se ky fenomen nuk është thjesht një reagim ndaj mbingarkesës aktuale.

Nga ana tjetër, është e logjikshme të mendohet se stoku i madh i çështjeve, i cili shkakton vonesa dhe zgjatje të afateve të shqyrtimit të çështjeve, do t'i shtynte gjyqtarët drejt masave më pak kufizuese për të evituar rrezikun e shkeljes së afateve ligjore të paraburgimit. Për këtë arsye, shpjegimi duhet kërkuar në sferën kulturore të vendimmarrjes gjyqësore.

Këtu bëhet i domosdoshëm koncepti i kulturës së rrezikut, i cili nuk e sheh vendimmarrjen gjyqësore si një zbatim mekanik të normës ligjore, por si proces të formësuar nga perceptimet e gjyqtarëve mbi rrezikun dhe pasigurinë. Në këtë kuptim, paraburgimi përdoret jo vetëm si masë sigurimi në kuptimin procedural, por edhe si mjet për të reduktuar pasiguritë institucionale, për të shmangur kritikën publike dhe për të demonstruar kontroll ndaj kriminalitetit.

Kjo lente teorike arrin të shpjegojë pse gjyqtarët zgjedhin arrestin në burg edhe në rastet kur janë të justifikuar ligjërisht masa të tjera shtrënguese, për të cilat nuk ka pengesa strukturore e insitucionale. Po ashtu, kjo teori mund të shpjegojë edhe pse gjyqtarët nuk heqin dorë nga caktimi i paraburgimit në këto nivele edhe pse GJEDNJ-ja ka dhënë disa vendime kundër Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese gjithashtu ka kritikuar mungesën e arsyesimit të detajuar dhe tendencën për të përdorur justifikime të përgjithshme mbi rrezikun e arratisjes apo të përsëritjes së krimit, pa analizuar rrethanat konkrete të rastit dhe aktorët politikë janë të shqetësuar edhe në nivel institucional për shkallën e përdorimit të paraburgimit.

Sipas teorisë së kulturës së rrezikut, institucionet shpesh marrin vendime që ulin rrezikun e tyre të brendshëm, edhe nëse kjo shkon në dëm të të drejtave të individit. Në Shqipëri, ky dimension i sigurisë institucionale shihet qartë në shkallën e miratimit të kërkesave të prokurorisë për caktimin e arrestit në burg nga gjykatat. Niveli gati mekanik i aprovimit tregon se gjyqtarët e shohin paraburgimin si zgjedhje më të sigurt për reputacionin e tyre, duke shmangur riskun e kritikave institucionale në rast se një i pandehur i liruar me masë më të butë kryen një vepër tjetër. Kjo sjellje është në përputhje me hipotezën se paraburgimi përjetohet si një 'mjet mbrojtjeje' për gjyqtarin dhe jo vetëm si instrument procedural.

Ngarkesa e madhe e punës, stoku i çështjeve dhe mungesa e burimeve njerëzore i shtojnë gjyqtarët drejt përdorimit të modeleve standarde të arsyetimit. Në termat e kulturës së rrezikut, kjo përfaqëson një formë menaxhimi kolektiv të pasigurisë. Për të shmangur vështirësitë e analizës së detajuar dhe individualizimit të masës, paraburgimi bëhet zgjedhja e zakonshme.

Në raste me profil të lartë, dimension i simbolik i kulturës së rrezikut bëhet evident. Gjyqtarët, të ndodhur nën presionin e opinionit publik dhe të medias, zgjedhin shpesh paraburgimin për të treguar vendosmëri në luftën kundër krimit dhe për të mbrojtur legjitimitetin e gjyqësorit. Kjo është në përputhje me analizën e Simon (2007), sipas të cilit paraburgimi shërben si instrument për të transferuar përgjegjësinë nga individit tek sistemi, duke treguar kontroll dhe ashpërsi përballë publikut.

Një dimension i rëndësishëm i kulturës së rrezikut është përforsimi i perceptimit se vetëm paraburgimi ofron siguri reale. Në Shqipëri, kjo hipotezë mbështetet fuqimisht nga të dhënat empirike. Mangësitë strukturore në zbatimin e masave shtrënguese i shtyn gjyqtarët drejt një praktike që e percepton masën më të rëndë si masën e vetme të efektshme. Ky realitet pasqyron hipotezën se mungesa e infrastrukturës alternative e kthen paraburgimin në një normë institucionale.

Sipas teorisë së kulturës së rrezikut, shoqëritë mbivlerësojnë ato rreziqe që janë më të dëmshme për institucionet sesa për individët. Në praktikën shqiptare, kjo manifestohet në perceptimin se kostoja e lirimit të gabuar është shumë më e lartë sesa kostoja e mbajtjes së një të dyshuari në paraburgim, edhe kur kjo bie ndesh me frymën e ligjit. Ky përfundim konfirmohet nga gjetja se gjykatat i konsiderojnë automatikisht të rrezikshëm personat përsëritës, pavarësisht natyrës së veprës apo nevojës së sigurimit. Kjo sjellje e standardizuar pasqyron pikërisht asimetrinë e rrezikut: gjyqtari e konsideron më të pranueshme padrejtësinë individuale sesa rrezikun institucional apo publik që mund të shkaktohej nga lirimi.

Analiza tregon se mbipërdorimi i paraburgimit në Shqipëri është një dukuri komplekse që nuk mund të reduktohet në një shpjegim të vetëm. Korniza ligjore është formalisht e përafuar me standardet europiane dhe parashikon proporcionalitetin, subsidiaritetin dhe një gamë masash alternative. Po kështu, faktorët strukturorë si ngarkesa e lartë e gjykatave, mungesa e burimeve njerëzore dhe deficitet infrastrukturore ofrojnë një pjesë të shpjegimit. Megjithatë, këta elementë nuk mjaftojnë për të kuptuar pse paraburgimi ka marrë statusin e një norme të brendësuar, pasi paraburgimi ka qenë praktikë dominante edhe përpara se këto probleme të arrinin përmasat e sotme. Kjo tregon se shkaqet e fenomenit janë më të thella dhe nuk kufizohen në dimensionin teknik apo logjistik.

Në këtë kuptim, analiza e kulturës së rrezikut bëhet e domosdoshme për të kuptuar pse gjyqtarët zgjedhin shpesh masën më të rëndë edhe kur ekzistojnë alternativa më të buta. Paraburgimi funksionon jo vetëm si mjet procedural, por edhe një strategji për të minimizuar pasiguritë personale dhe institucionale. Duke e konsideruar koston e lirimit të gabuar më të lartë se padrejtësinë e mbajtjes së një të dyshuari në burg, gjyqtarët zgjedhin masën më të ashpër për të mbrojtur reputacionin dhe legjitimitetin e sistemit. Për rrjedhojë, mbipërdorimi i paraburgimit nuk është thjesht një problem ligjor apo teknik, por një produkt i ndërthurjes së faktorëve juridikë, strukturorë dhe kulturorë, çka nënkupton se kjo çështje është rezistente ndaj reformave të pjesshme dhe kërkon qasje shumë më të thellë, nëse dëshirohet të arrihet një ndryshim i qëndrueshëm.

[1] Megjithëse nuk ekzistojnë burime që të provojnë se Frenk e ka bërë këtë deklaratë, në një nga veprat e tij ai argumenton se edhe problemet e tretjes mund të ndryshojnë paragjykimet, të cilat ndikojnë mbi diskrecionin gjyqësor (Frank, 1930).

[2] Vendimmarrja gjyqësore mbetet një fushë sfiduese për studiuesit, pasi është e vështirë, në mos e pamundur, të përdoren një sërë metodash kërkimore empirike e bihejviorale. Megjithatë, studimi i kësaj fushe është me rëndësi në një nivel individual për qytetarët, pasi studimet konfirmojnë se mënyra se si një person ndihet gjatë kontaktit me sistemin gjyqësor është parashikues i rëndësishëm i gadishmërisë së tij për të zbatuar ligjin më vonë (Tyler, 2006). Por, çka është më e rëndësishme, mënyra se si gjyqtarët marrin dhe duhet të marrin vendime është një element thelbësor i legjitimitetit të vendimmarrjes gjyqësore (Riesthuis, 2023).

[3] Laureati i çmimit Nobel, Daniel Kaneman, e përshkruan kështu procesin e arsytimit njerëzor: 'Kur të pyesin se për çfarë po mendon, ti mund të përgjigjesh normalisht. Ti beson se e di çfarë ndodh në mendjen tënde; shpesh ajo që ndodh është që mendimet të çojnë me radhë nga njëri tek tjetri. Por kjo nuk është mënyra e vetme se si funksionon mendja; madje, kjo nuk është as mënyra tipike. Shumica e përshtypjeve dhe mendimeve krijohen në përvojën tënde të vetëdijshme, por ti nuk e di se si kanë arritur atje. Nuk je në gjendje të gjurmosh se si ke krijuar bindjen se ka një llambë mbi tavolinën para teje ose se si dallove një shenjë acarimi në zërin e bashkëshortes tënde në telefon ose se si arrite të shmangie një rrezik në rrugë përpara se të bëheshe i vetëdijshëm për ekzistencën e tij.' (Kahneman, 2011)

[4] Heuristikat janë rrugë të shkurtra mendore që truri i përdor për të thjeshtëzuar gjykime komplekse, veçanërisht në situata me mungesë informacioni apo në presion të lartë.

[5] I njohur si 'anchoring bias' (Tversky & Kahneman, 1974). Kur u paraqitet një detyrë sasiore, por nuk kanë informacionin e saktë numerik, gjykimi i gjyqtarëve ndikohet nga çdo numër me të cilin krahasohet sasia e panjohur. Ky efekt mund të shfrytëzohet në mënyrë strategjike nga palët, të cilët mund të sugjerojnë numra, sipas interesit të tyre.

[6] I njohur si 'framing bias' (Tversky & Kahneman, 1981). Gjyqtarët ndikohen në vlerësim nga prezantimi i një vendimi të mundshëm si fitore apo si humbje.

[7] Gabimi i kumarxhiut është besimi i gabuar se ngjarje të rastësishme në të shkuarën ndikojnë mbi ngjarje në të ardhmen, p.sh.: se monedha 'duhet' të bjerë 'kokë' pasi ka rënë disa herë rresht 'pil'. Gjyqtarët bien në këtë gabim, pasi nënvleftësojnë se sa e mundur është që të kenë disa çështje të ngjashme rresht, duke pritur gabimisht që ky model të ndryshojë, ndërkohë që vargu i çështjeve është krejt rastësor.

[8] I njohur si 'hindsight bias'. Kur mësojnë se një ngjarje e mundshme ka ndodhur vërtet, gjyqtarët e rrisin probabilitetin e vlerësuar më parë që ajo të ndodhte.

[9] Gjyqtarët, shpesh, nuk janë në gjendje të dallojnë mes probabilitetit të kushtëzuar dhe atij të pakushtëzuar (mundësia që një ngjarje të ndodhë, në përgjithësi, ose që të ndodhë në kushte të caktuara). Gjyqtarët nuk e përdorin gjithmonë informacionin që ekziston për mënyrën se si ndodhin gjërat zakonisht.

[10] Siç tregojnë kërkimet shkencore, kompleksiteti dhe paqartësia krijojnë hapësira për arsytim të motivuar, gjatë të cilit njerëzit e interpretojnë informacionin në mënyrën që mbështet konkluzionin e dëshiruar prej tyre. Ata e bëjnë këtë duke krijuar histori: i bashkojnë provat në mendjen e tyre, duke krijuar një narrativë koherente. Në psikologji, ky model quhet procesi paralel i përmbushjes së kufizimeve (Simon, 1998), në të cilin vendimmarrësi shkon e vjen ndërmjet provave dhe interpretimeve të mundshme të tyre, derisa të vendosë për një histori që përmbush standardin ligjor përkatës të të provuarit.

[11] Sa më me vetëbesim të paraqitet dëshmitari, aq më e madhe është mundësia që dëshmia e tij të merret parasysh, pavarësisht se sa e saktë është. Mekanizmat proceduralë, si pyetja e kryqëzuar, nuk e lehtësojnë këtë problem, ndërkohë që nuk është e mundur të dallohet se kush gënjen. Njohjet e personave janë një element tjetër shqetësues. Kur i dyshuari bie në sy në grupin e zgjedhur, është më e mundshme që ai të identifikohet gabimisht. Provat eksperimentale tregojnë se njohjet nuk janë të

besueshme, sidmos kur policia sugjeron se kush duhet të njihet.

[12] Pohimet e marra nën shtrëngim kanë shumë ndikim, edhe kur shtrëngimi është i dukshëm. Për më tepër, këto pohime bëhen edhe më të besueshme nëse kombinohen me stereotipe racore ose etnike; p.sh.: pohimet e bëra nga të pandehur zezakë ose nga Lindja e Mesme në çështje terrorizmi apo bandash të armatosura besohen me lehtë, pavarësisht se sa i besueshëm është pohimi. Edhe kur pohimi tërhiqet, ai e ruan në një masë të madhe efektin.

[13] Gjyqtarët i japin më shumë vlerë përmbledhjeve cilësore se sa shifrave të detajuara dhe nuk marrin parasysh paralajmërimet e ekspertëve për kufizimet apo mangësitë e raportit. Mënyra se si prezantohen provat shkencore ndikon në mënyrë thelbësore në rezultatin e çështjes, edhe kur të dhënat janë të njëjta.

[14] Zakonisht, i pandehuri flet i fundit. Kjo i jep mundësi prokurorit të vendosë një spirancë (paragykimi i ankorimit) kur argumenton akuzën. Megjithatë, eksperimentet tregojnë se, në vlerësimin e kombinuar të informacionit të paqartë të çështjes, argumentat që janë dëgjuar të fundit kanë ndikimin më të madh në vendim. Ky efekt i fjalës së fundit vërehet edhe në radhën e prezantimit të provave apo në prezantimin e një dëshmie okulare që fajëson të pandehurin. Efekti i fjalës së fundit përdoret nga avokatët për të krijuar një përshtypje më favorizuese tek gjyqtarët.

[15] Një studim interpreton vendimin e Gjykatës Supreme të SHBA-së në çështjen Booker si një eksperiment natyral. Në atë vendim, Gjykata Supreme u kishte dhënë gjykatave të shkallës së parë më shumë hapësirë për të devijuar nga masat e dënimeve të përcaktuara në udhëzuesit përkatës. Gjykatat e shkallës së parë e shfrytëzuan mundësinë menjëherë, duke qenë më të prirura për të ulur se sa për të rritur dënimet.

[16] Studimet kanë treguar se prezenca e kamerave në sallën e gjyqit nuk ka ndikim, kurse cilësia e audios në videokonferencë ka ndikim. Kur cilësia e audios është e dobët, dëshmitarët vlerësohen si më pak të besueshëm, gjyqtarët nuk i mbajnë mend mirë deklaratimet e tyre dhe këto kanë pak ndikim në vendimmarrje.

[17] Një eksperiment i kryer në Izrael mati efektin e pakësimit të ngarkesës tek mënyra se si gjyqtarët gjykojnë. Rezultoi se gjyqtarët e përdorin kohën e fituar për të punuar më shumë dhe më me kujdes me çështjet që kanë, por edhe se, në çështjet civile, ky kujdes i shtuar shkon në favor të paditësave, të cilët fitojnë më shpesh. Në një eksperiment me studentë të juridikut është treguar se presioni i kohës rrit mundësinë që pjesëmarrësit të zbatojnë ligjin në mënyrë mekanike, por edhe se ata janë më pak të sigurt në vendimmarrje.

[18] Në shumicën e rasteve, gjyqtarët e shkallës së parë vendosin duke konsideruar rrezikun që çështja mund të apelohe. Një efekt i kësaj është vetëvlerësimi (gjyqtari nuk do të bëjë gabim), kurse një tjetër është vlerësimi social (gjyqtari nuk do që t'i cënohet reputacioni, nëpërmjet prishjes së një vendimi). Në një eksperiment, këto efekte sollën një shkallë më të lartë saktësie në vendime.

[19] Një studim tregon se, nëse gjyqtarët perceptohen si të drejtë, njerëzit e respektojnë autoritetin e tyre, edhe nëse nuk janë dakord me vendimin. Në të kundërt, nëse gjyqtarët perceptohen si aktorë politikë, njerëzit respektojnë vetëm vendime, me të cilat bien dakord personalisht. Në Norvegji, ku gjyqësori shihet si pak i politizuar, mbështetja publike rritet kur vendimi ka një mendim pakice, i cili e bën transparent konfliktin në interpretim.

[20] Neni 27.

[21] Prokuroria e Përgjithshme raporton se, për vitin 2024, për 59,97 % të të pandehurve të regjistruar është kërkuar caktimi i një mase sigurimi shtrënguese dhe se 59,51% e kërkesave, lidhet me caktimin e një mase sigurimi me arrest në burg (PP, 2025).

[22] Për vitin 2024, kjo mesatare është llogaritur në 25,9%. (Aebi&Cocco, 2025).

[23] Sipas parametrave të raportit SPACE 1 (Aebi&Cocco, 2025), më shumë se gjysma e të paraburgosurve në Shqipëri janë në proces gjykimi në shkallë të parë. I njëjti raport tregon se numri i personave në burg në Shqipëri është 191,2 për 100 000 banorë ose 1,8 herë më i lartë se mesatarja europiane

prej 104,8. Parë nga një dimension tjetër, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (2020) ka llogaritur se shpenzimet vjetore për të paraburgosurit arrijnë rreth 2.29 miliardë lekë, duke e kthyer paraburgimin jo vetëm në një çështje të drejtave të njeriut, por edhe në një barrë të madhe ekonomike për buxhetin e shtetit (KSHH, 2020). Në lidhje me këtë, KLSH ka evidentuar një sërë indikatorësh që tregojnë mungësën e efektivitetit të sistemit të paraburgimit për të ofruar kushte dhe garantuar të drejtat e të paraburgosurve (KLSH, 2022).

[24] 'Zbatimi më i gjerë dhe më i standardizuar i këtyre masave ndihmon jo vetëm në shmangien e mbipopullimit të sistemit penal dhe paraburgimeve të panevojshme, por edhe në promovimin e një drejtësie më sociale dhe më efektive. Rekomandohet që prokuroria të zhvillojë udhëzime të brendshme dhe trajnime të posaçme për zbatimin e këtyre formave alternative, si dhe të monitorojë praktikën për të siguruar konsistencë dhe qasje të barabartë në të gjithë sistemin' (KM, 2025).

[24] Një raport auditimi i KLSH-së për performancën e shërbimit të paraburgimit evidenton përdorimin e tepruar të paraburgimit dhe argumenton se 'shpesh është një simptomë e mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale' (KLSH, 2022).

[25] INFOÇIP ka gjetur se, në vitin 2023, kohëzgjatja e një çështjeje gjyqësore ishte trefishuar në krahasim me vitin 2016 (INFOÇIP, 2023). Të dhëna nga Këshilli i Lartë Gjyqësor tregojnë se, në 2023, gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit kishin 113.768 çështje të prapambetura, kurse Gjykata e Lartë kishte 24.000 (KLGJ, 2024). Këto të dhëna janë mbresëlënëse, nëse mbahet parasysh sasia e vendimmarrjes gjyqësore vjetore: 50.000 çështje për gjykatat e ulëta dhe 8.000 për Gjykatën e Lartë (KLGJ, 2024).

[26] Sipas të dhënave të KPK-së, norma e konfirmimit të gjyqtarëve në detyrë ka qene 44,35% (KPK, 2024), ndërkohë që norma e emërimit të gjyqtarëve të rinj dhe promovimit brenda sistemit ka qënë e ulët (KLGJ, 2024).

[27] Megjithë përpjekjet, ka rezultuar e vështirë ngritja e kësaj infrastrukture ndihmëse, për shkak të procedurave strikte të përzgjedhjes së ndihmësve, të cilat përfshijnë një trajnim paraprak dhe të detyrueshëm në Shkollën e Magjistraturës, si dhe për shkak të interesit të ulët për të ndjekur këtë karrierë (KLGJ, 2024).

- Aebi, M. F., & Cocco, E. (2025). SPACE I - 2024 – Council of Europe annual penal statistics: Prison populations. Council of Europe.
- Anastasi, A. (2021). The Albanian justice reform in the framework of the European integration process. *Euro-Balkan Law and Economics Review*, 2, 1–22. <https://doi.org/10.15162/2612-6583/1317>
- Bentsen, H. L. (2019). Dissent, legitimacy, and public support for court decisions: Evidence from a survey-based experiment. *Law and Society Review*, 53(2), 588–610.
- Bild, E., Redman, A., Newman, E. J., Muir, B. R., Tait, D., & Schwarz, N. (2021). Sound and credibility in the virtual court: Low audio quality leads to less favorable evaluations of witnesses and lower weighting of evidence. *Law and Human Behavior*, 45(5), 481–495.
- Bystranowski, P., Janik, B., Próchnicki, M., & Skórska, P. (2021). Anchoring effect in legal decision-making: A meta-analysis. *Law and Human Behavior*, 45(1), 1–23.
- Cape, E., & Namoradze, Z. (2012). Effective criminal defence in Eastern Europe. Soros Foundation–Moldova.
- Cardozo, B. (1921). *The nature of the judicial process*. Yale University Press.
- Chen, D. L., Moskowitz, T. J., & Shue, K. (2016). Decision making under the gambler's fallacy: Evidence from asylum judges, loan officers, and baseball umpires. *Quarterly Journal of Economics*, 131(3), 1181–1242.
- Choi, D. D., Harris, J. A., & Shen-Bayh, F. (2022). Ethnic bias in judicial decision making: Evidence from criminal appeals in Kenya. *American Political Science Review*, 116, 1067–1080.
- Council of Europe, Committee for the Prevention of Torture. (2024). Report to the Albanian Government on the periodic visit to Albania (CPT/Inf (2024) 01). Council of Europe. <https://www.coe.int/en/web/cpt/albania>
- Douglas, M. (1992). *Risk and blame: Essays in cultural theory*. Routledge.
- Engel, C., & Weinshall Margel, K. (2020). Manna from heaven for judges: Judges' reaction to a quasi-random reduction in caseload. *Journal of Empirical Legal Studies*, 17, 722–751.
- Engel, C., & Zhurakhovska, L. (2017). You are in charge: Experimentally testing the motivating power of holding a judicial office. *Journal of Legal Studies*, 46, 1–50.
- Englich, B., Mussweiler, T., & Strack, F. (2005). The last word in court: A hidden disadvantage for the defense. *Law and Human Behavior*, 29(6), 705–722.
- European Commission, Directorate-General for Justice and Consumers, Asterisk, CSES, & VVA. (2022). Rights of suspects and accused persons who are in pre-trial detention (exploratory study) – Final report. Publications Office of the European Union. <https://data.europa.eu/doi/10.2838/293366>
- Fair Trials. (2014). Pre-trial detention in the EU [Policy report].
- Fair Trials. (2020). Roadmap to the EU: Advancing procedural rights in Albania. Fair Trials. <https://www.fairtrials.org/publication/roadmap-to-the-eu-advancing-procedural-rights-in-albania>
- Feeley, M., & Simon, J. (1992). The new penology: Notes on the emerging strategy of corrections and its implications. *Criminology*, 30(4), 449–474. <https://doi.org/10.1111/j.1745-9125.1992.tb01112.x>
- Feess, E., & Sarel, R. (2018). Judicial effort and the appeals system: Theory and experiment. *Journal of Legal Studies*, 47(2), 269–294.
- Funk, F., & Todorov, A. (2013). Criminal stereotypes in the courtroom: Facial tattoos affect guilt and punishment differently. *Psychology, Public Policy, and Law*, 19(4), 466–478.
- Girvan, E. J. (2016). Wise restraints?: Learning legal rules, not standards, reduces the effects of stereotypes in legal decision-making. *Psychology, Public Policy, and Law*, 22(1), 31–45.
- Guthrie, C., Rachlinski, J. J., & Wistrich, A. J. (2001). Inside the judicial mind. *Cornell Law Review*, 86, 777–830.
- Hannah-Moffat, K. (2005). Criminogenic needs and the transformative risk subject: Hybridizations of risk/need in penalty. *Punishment & Society*, 7(1), 29–51. <https://doi.org/10.1177/1462474505048132>
- Hofer, P. J. (2007). United States v. Booker as a natural experiment: Using empirical research to inform the federal sentencing policy debate. *Criminology and Public Policy*, 6(3), 433–460.

- Kahneman, D. (2011). *Thinking, fast and slow*. Farrar, Straus and Giroux.
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. (2024, December). Raport statistikor shkurt 2018 – nëntor 2024. KPK. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2024/12/Raport-statistikor-shkurt-2018-30-nentor-2024.pdf>
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. (2024). Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024–2027). KLGJ. <https://klgj.al/media/rpkbir1x/strategjia-e-uljes-s%C3%AB-numrit-t%C3%AB-%C3%A7%C3%ABshjtjeve-t%C3%AB-prapambetura-2024-2027.pdf>
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2022). Performanca e shërbimit të parburgimit.
- Miller, A. L. (2019). Expertise fails to attenuate gendered biases in judicial decision-making. *Social Psychological and Personality Science*, 10(2), 227–234.
- Morgenstern, C., Hammerschick, W., & Rogan, M. (2023). European perspectives on pre-trial detention: A means of last resort? Routledge. <https://doi.org/10.4324/9781003159254>
- Oberst, A., & Goeckenjan, I. (2016). When being wise after the event results in injustice: Evidence for hindsight bias in judges' negligence assessments. *Psychology, Public Policy, and Law*, 22(3), 271–279.
- Ora News. (2025, July 28). 85 policë për ruajtjen e 7 personave në arrest shtëpie/ Ilir Proda shkresë Ministrisë së Drejtësisë: Të kthehet mbikëqyrja elektronike, policët të angazhohen me rendin dhe sigurinë. OraNews. <https://www.oranews.tv/vendi/85-police-per-ruajtjen-e-7-personave-ne-arrest-shtepie-ilir-proda-shkrese-i1257880>
- Organization for Security and Co-operation in Europe, OSCE Presence in Albania. (2003). Pre-trial detention situation survey. OSCE.
- Organization for Security and Co-operation in Europe, OSCE Presence in Albania. (2006). Analysis of the criminal justice system of Albania. OSCE. <https://www.osce.org/albania/22211>
- Priel, D. (2017). What the judge had for breakfast: A brief history of an unpalatable idea. SSRN. <https://doi.org/10.2139/ssrn.2982716>
- Prokuroria e Përgjithshme. (2025, Mars). Raporti vjetor i ngarkesës 2024: Raporti i ngarkesës së punës së prokurorive. [https://www.pp.gov.al/rc/doc/1RAPORTI\\_I\\_NGA\\_RKESES\\_SE\\_PUNES\\_S\\_PROKURORIVE\\_P\\_R\\_VITIN\\_2024\\_7730.pdf](https://www.pp.gov.al/rc/doc/1RAPORTI_I_NGA_RKESES_SE_PUNES_S_PROKURORIVE_P_R_VITIN_2024_7730.pdf)
- Qendra për Çështje të Informimit Publik (INFOÇIP). (2023). Kohëzgjatja gjyqësore në apel dhe afatet e gjykimit të arsyeshëm 2016–2023. Tiranë: INFOÇIP. <https://www.infocip.org/al/wp-content/uploads/2023/11/raporti-2023-Final-me-Kopertine.pdf>
- Quinn, J. (2002). Public expectations and judicial behavior. *Journal of Law and Society*, 29(3), 336–354.
- Rachlinski, J. J., Johnson, S. L., Wistrich, A. J., & Guthrie, C. (2008). Does unconscious racial bias affect trial judges? *Notre Dame Law Review*, 84, 1195–1246.
- Segal, J. A., & Spaeth, H. J. (1993). *The Supreme Court and the attitudinal model*. Cambridge University Press.
- Shërbimi i Provës. (2024). Statistika DME [Të dhëna statistikore zyrtare]. Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë. <https://www.sherbimiproves.gov.al/statistika-dme/>
- Simon, D. (1998). A psychological model of judicial decision making. *Rutgers Law Journal*, 30, 1–142.
- Simon, D. (2004). A third view of the black box: Cognitive coherence in legal decision making. *University of Chicago Law Review*, 71, 511–586.
- Simon, J. (2007). *Governing through crime*. Oxford University Press.
- Skeem, J., Scurich, N., & Monahan, J. (2020). Impact of risk assessment on judges' fairness in sentencing relatively poor defendants. *Law and Human Behavior*, 44(1), 51–59.
- Sonnemans, J., & Van Dijk, F. (2012). Errors in judicial decisions: Experimental results. *Journal of Law, Economics, and Organization*, 28(4), 687–716.
- Stevenson, M. (2018). Assessing risk assessment in action. *Minnesota Law Review*, 103(1), 303–384.
- Sufaj, F. (2009). Masat e sigurimit personal në procesin penal shqiptar. Albanian Journal for Legal Studies, IVth Annual Meeting, Institute Alb-Shkenca.

- Sunstein, C. R., & Jolls, C. (2004). Debiasing through law (John M. Olin Program in Law and Economics Working Paper No. 225). University of Chicago.  
[https://chicagounbound.uchicago.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1157&context=law\\_and\\_economics](https://chicagounbound.uchicago.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1157&context=law_and_economics)
- Tversky, A., & Kahneman, D. (1974). Judgment under uncertainty: Heuristics and biases. *Science*, 185(4157), 1124–1131.  
<https://doi.org/10.1126/science.185.4157.1124>
- Viljoen, J. L., Jonnson, M. R., Cochrane, D. M., Vargen, L. M., & Vincent, G. M. (2019). Impact of risk assessment instruments on rates of pretrial detention, postconviction placements, and release: A systematic review and meta-analysis. *Law and Human Behavior*, 43(5), 397–420.
- Woodson, B. (2015). Politicization and the two modes of evaluating judicial decisions. *Journal of Law and Courts*, 3(2), 193–221.